



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor 2026-2028

Data: 29.08.2025

Ora: 11:00

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal, Kati IV

Të pranishëm: Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Ismet Aliu; Drejtoresha e Drejtorisë për zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm, znj. Besarta Meha Ademi; Drejtori i Inspektoratit Komunal, z. Valon Haliti

Ismet Aliu: Përshëndetje për të gjithë, draft buxhetit për vitin 2026, 2028, është në fazën e tretë. Hartimi i buxhetit është një proces mjaft i ndërlikuar dhe kërkon angazhimin e të gjithë akterëve duke filluar nga ekzekutivi, shoqëria civile, bizneset, OJQ-të, të gjithë qytetarët mund të japin kontributin e vet, për arsye se qytetarët janë ata vetë që e financojnë buxhetin e Kosovës dhe Komunave, dhe duhet të jenë vendimmarrës në shpenzimin e tij. Sa i përket buxhetit për vitin 2026 ekzekutivi i Komunës ka punuar vazhdimisht duke filluar nga maji, qershori dhe tani në korrik dhe gusht për ta finalizuar buxhetin. Hapi i parë ka qenë qarkorja buxhetore të cilën e kemi marrë nga Ministria e Financave dhe janë caktuar burimet e financimit që komuna jonë në vitin 2026 do të ketë një buxhet prej 20,245,395, një buxhet i cili nuk ka ngritje në vitin 2026 dhe i cili adresohet më së shumti nga kriteri i popullsisë. Ju e dini se regjistrimi i popullsisë në vitin 2024 që është bërë, është kriteri numër një (1) për komuna për t'u ndarë buxheti, është kriter që 89% e buxhetit ndahet për numër të banorëve dhe ne kemi pasur një rënie të numrit të banorëve diku 20%, çka ka ndodhur që ne ligjërisht është dashur të kemi një buxhet më të vogël, por për arsye të specifikave buxheti i vitit 2026 nuk mund të jetë më i ulët se i vitit 2025, me një përqindje prej 1.83% me rritje nga të hyrat komunale. Meqenëse komuna merr pjesë në buxhet për financim edhe me pjesën e hyrave komunale, ne kemi hartuar kornizën afatmesme buxhetore, e kemi ndërtuar një strukturë e cila është aprovuar në qershor dhe është dërguar në Ministri të Financave, për ta marrë strukturën përfundimtare, ku tani e kemi marrë me qarkoren dytë dhe jemi në fazën finale ku në shtator pritet t'i kalojë në kompetencë nga kryetari i Komunës t'i kalojë Kuvendit ku pritet të aprovohet. Të gjitha të dhënat do të përpunohen në sistem dhe buxheti i Komunës do të jetë pjesë e konsoliduar e buxhetit të Republikës së Kosovës. Për të ardhur deri te një strukturë dhe një kornizë që e kemi ndërtuar, ju e keni një fletushkë përpara që e ka hartuar Instituti GAP për të parë orientimet se kah kanë ardhur mjetet prej grantit specifik dhe grantit të përgjithshëm, grantit për arsim, grantit për shëndetësi, prej të hyrave vetanake, shërbimet rezidenciale, të gjitha aty janë. Këto janë të dhëna tona që i kemi përpunuar gjatë qershorit dhe kanë shkuar në Ministri dhe është nxjerrë një strukturë, dhe tani kjo strukturë për arsye të ndryshme ndikimit të ligjit të LVL ku komuna jonë

do të renditet në grupin e 4 të komunave, me numër të banorëve prej 30 mijë deri në 50 mijë dhe kjo ka bërë të kemi një strukturë pak më ndryshe, pak më pak të volitshme por megjithatë ky është kapaciteti i shtetit tonë financiar dhe duhet në përpikmëri ta zbatojmë dhe ta aprovojmë në Kuvendin Komunal. Kemi ndërtuar një strukturë këto ditë, pothuajse është preliminar, me përfundim të pjesës së projekteve kapitale. Në faqen e fundit të fletushkës janë projektet e planifikuara për vitin 2026, disa janë vazhdim, disa janë të reja, por komuna jonë gjatë vitit 2026 do të ketë 3,181,122 EURO, kanë me qenë shpenzime komunale rreth 291,900 EURO, kanë me qenë subvencione dhe transfere 1,190,000 EURO, dhe kanë me qenë në projektet kapitale 3,100,947. Është hartuar lista, ka pak ndryshime nga kjo fletushkë, por ne presim edhe kontributin e juaj sot në këtë takim, në mënyrë që kërkesat e juaja të cilat janë të arsyeshme, të cilat janë gjithëpërfshirëse edhe për qytetarët dhe bizneset për të gjithë, mund ta ndryshojmë buxhetin deri në momentin e aprovimit që do të dorëzohet në Ministrinë e Ministrinë e Financave. Faleminderit, fjala është për juve.

Rushit Jeta: Përshëndetje për të gjithë, jam banor i Skenderajt dhe deshta të ndalem në dy pika. E para është tribunat e stadiumit të qytetit 75 mijë Euro, a është tash përgjegjësi e Komunës apo ne e dimë që është privatizu klubi dhe i kalon klubit kjo çështje? Dhe e dyta është një çështje kognia e rëndësishme për komunitetin prej nga vi, është një rrugë e paasfaltuar në fshatin Tice diku me rreth 20 shtëpi dhe nëse kishit pasur mundësi ta planifikoni në buxhet.

Ismet Aliu: Në vitin 2026 janë të përfshira në projektet kapitale edhe tribuna. Është një kontratë e lidhur e cila duhet të përfundojë për pjesën të cilën e ka kontraktuar Komuna, ndërsa nga vitet e ardhshme sigurisht se nuk kanë kaluar të gjitha procedurat e privatizimit të klubit dhe do të qartësohen të gjitha investimet që ka me i pas ai në raport me objektet sportive apo me pjesën e logjistikës. Ndërsa për rrugën në Tice do të shikojmë mundësinë se a është ajo pjesa duke u banuar me qytetar, se shumë pjesë kanë mbetur vetëm shtëpitë e pabanuara, dhe normal aty ku është e arsyeshme të investohet Komuna menjëherë do të përkujdeset për realizimin e projekteve për me qenë të shfrytëzueshme. Këtë çështje do ta diskutoj edhe drejtori i Urbanizimit, nëse është e arsyeshme ai do të na e japë propozimin dhe ne do ta fusim në buxhetin 2026.

Drita Mala: A do të ndajë Komuna subvencione për bizneset e vogla?

Xhevrije Thaçi: Përshëndetje, unë kam hapur një biznes për prodhimin e lëngjeve bio dhe kam nevojë për mbështetje nga Komuna në mjete dhe në sigurimin e një objekti.

Besarta Meha Ademi: Përshëndetje për të gjithë, Drita ju keni qenë përfutuese e grantit nga Komuna e Skenderajt, dhe tash ju duhet edhe një vit të prisni për të kaluar periudha 3 vjeçare për të pasur të drejtë për të aplikuar në grante. Sa i përket biznesit tjetër duhet t'i përcillni thirrjet të cilat janë publike ku thirrjet zakonisht janë për biznese të vogla dhe të mesme. Siç po e shihni edhe në fletushkë është pjesa që është ndarë për subvencione për Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik.

Muhamet Bajrakatari: Përshëndetje, a keni planifikuar diçka për fermerët që merren me kafshët qumështore?

Ismet Aliu: Ne si ekzekutiv zakonisht e planifikojmë një buxhet dhe në lëmin e bujqësisë, veç e kemi planifikuar, drejtori është kompetent se në cilat fusha dhe shpalljet dhe cilat kanë me qenë kriteret për përfutues. Por megjithatë buxhet ka mjaftueshëm edhe vitin e ardhshëm siç ka pasur edhe në këto vite dhe vitet e kaluara.

Hazir Thaçi: Një pyetje e kam, a është kriter kalimi i kohës prej 3 vjet për të pasur të drejtë për të aplikuar për subvencionim pasi që unë vitin e kaluar kam qenë përfitues?

Besarta Meha Ademi: Vitin e kaluar i kemi mbështetur 12 biznese në rrugën Ilaz Kodra, së bashku me UNDP. Aty nuk ka qenë kriter koha prej 3 vite, do të vazhdojmë bashkëpunimin me UNDP edhe këtë vit.

Xhevrije Thaçi: Kërkoj nga Komuna e Skenderajt të më ndihmojë në sigurimin e një lokali për biznesin që kam.

Besarta Meha Ademi: Të gjitha grantet që i kemi dhënë deri sot kanë qenë vetëm për sigurim të pajisjeve, jo edhe pjesën e ndërtimit. Sigurisht nëse kemi ndonjë donator për diçka të ngjashme do t'ju informojmë. Sa i përket pronave që jepen në shfrytëzim është kompetencë e Drejtorisë për Gjeodezi dhe ka evidencat për objektet që janë në pronësi të Komunës.

Ismet Aliu: Faleminderit, atëherë ne i kemi marrë kërkesat e juaja, do të ulemi t'i shqyrtojmë dhe aty ku ka mundësi do t'i fusim në buxhet në vitin 2026 por edhe në parashikimet për 2027 dhe 2028. Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe shihemi në dëgjimet e ardhshme buxhetore.

Procesmbajtësi: **Ilir Kabashi**





Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Dëgjimi buxhetor me grupet e grave, studentët dhe të rinjtë, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara dhe qytetarë të tjerë

Vendi dhe data: E premte, 29 Gusht 2025
Salla e Kuvendit Komunal, Skenderaj

[illegible]



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Dëgjimi buxhetor me përfaqësuesit e bizneseve dhe fermerët e komunës së Skenderajt

Vendi dhe data: E premte, 29 Gusht 2025, ora 11:00

Salla e Kuvendit Komunal, Skenderaj

Emri dhe Mbiemri	Përfaqësimi	Nënshkrimi
ALBINA RUSHTI	K. SKENDERAJ	
Shqipona Roma	K.K. Skenderaj	
Sabihate Nurseti Syloraj	K.K. Skenderaj	
Rozeta Shalci	K.K. Skenderaj	
Mentinda Denguti	K.K. Skenderaj	
Antigona Maliqi	K.K. Skenderaj	
Fjolla Hiu	K.K. Skenderaj	
Aziza Geci	K.K. Skenderaj	
Blerend Shexha	K.K. Skenderaj	
Syle Dibrani	K. Skenderaj	
Sokol Haziraj	K.K. Skenderaj	
LULJETA BIRAKTARI	K.K. Skenderaj	
Rusht Jeta	K.K. Skenderaj	



Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Dëgjimi buxhetor me grupet e grave, studentët dhe të rinjtë, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara dhe qytetarë të tjerë

Vendi dhe data: E premte, 29 Gusht 2025
Salla e Kuvendit Komunal, Skenderaj

Emri dhe Mbiemri	Përfaqësimi	Nënshkrimi
ALBINA RUSHITI	K. SKENDERAJ	
Shajpeza Ramo	R. K. Skenderaj	
Befi Begri	K. K. Skenderaj	
Sababete Hajset Sylaj	K. K. Skenderaj	
Redena Shala	K. K. Skenderaj	
Menlinda Dergjiri	K. K. Skenderaj	
Jolka Flu	K. K. Skenderaj	
Antigona Maligi	K. K. Skenderaj	
Elona Gashi	K. K. Skenderaj	
Xhevnije Thaqi	K. K. Skenderaj	
Mania Zekaj	DRUCEZA	
Drita Mjaka	Bietariga LEJ	
Hazir Thaqi	Subway Piza	



Komuna Skenderaj

Opština Skenderaj

Municipality of Skenderaj

Vendi dhe data: E premte, 29 Gusht 2025
Salla e Kuvendit Komunal, Skenderaj

[illegible]